



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KOORDINATOR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. _____ Prot

Shijak, më _____.____.2026.

Lënda: Kthim përgjigje mbi rrinë dhe përfshirjen sociale për vitin 2025

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, paraqitur në mbështetje të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, lidhur me rrinë dhe përfshirjen sociale për vitin 2025 në Bashkinë Shijak, ju informojmë si më poshtë vijon :

1. Për periudhën janar-dhjetor 2025, Bashkia Shijak ka planifikuar për rrinë një fond që përbën 2% të buxhetit vjetor të bashkisë.
2. Gjatë vitit 2025 Bashkia Shijak nuk ka përfituar nga projekte të financuara nga donatorë që synojnë rrinë.
3. Numri total i punonjësve në Bashkinë Shijak për vitin 2025 është 346 punonjës, nga të cilët 183 femra dhe 163 meshkuj. Në institucion është 1 punonjëse femër me aftësi të kufizuar.
4. Numri i të rinjve (18-29 vjeç) të punësuar pranë Bashkisë Shijak është 44, nga të cilët 26 femra dhe 18 meshkuj
5. Numri i të rinjve (18-29 vjeç) që mbajnë pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse është 2(dy), konkretisht:
 - 1 femër, Administratore e Njesisë Administrative Xhafzotaj;
 - 1 mashkull, Administrator i Njesisë Administrative Gjepalaj.
6. Bashkia Shijak nuk ka politika rinore specifike të zhvilluara për grupmoshën 15-29 vjeç.

7. Në strukturën e Bashkisë Shijak është parashikuar pozicioni i Koordinatorit për Rininë, pjesë e Sektorit të Integritimit Evropian dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj. Ky funksion ushtrohet nga znj. A.F dhe është funksional prej vitit 2022.

- e-mail:
- Nr.cel:

Ndër përgjegjësitë kryesore janë:

- Propozimi i mekanizmave për integrimin e të rinjve në praktika profesionale;
- Koordinimi i aktiviteteve dhe projekteve rinore;
- Përgatitja e materialeve informuese dhe koordinimi i aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive;
- Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete dhe trajnime.

8. Bashkia Shijak ka ngritur Këshillin Rinor Vendor (KVR), i cili është funksional që nga viti 2022.

9. Për ngritjen e Këshillit Rinor Vendor është bashkëpunuar me Agjencinë Kombëtare të Rinisë, bazuar në manualin për ngritjen e strukturave rinore.

10. Bashkia Shijak nuk disponon një Plan Vendor Veprimi për Rininë. Të rinjtë përfshihen në dëgjesa dhe konsultime publike ku adresojnë problematikat e tyre.

11. Në lidhje me Këshillin Rinor Vendor:

- Viti i krijimit: 2022;
- Numri i anëtarëve: 7 (shtatë) ;
- Përbërja: 2 (dy) përfaqësues të Bashkisë Shijak dhe 5 (pesë)të rinj;
- Nga 5 (pesë) të rinjtë: 3 (tre) femra dhe 2 (dy) meshkuj;
- Nuk ka anëtarë me aftësi të kufizuara;
- Ne vitin 2025 janë zhvilluar 5 (pesë) mbledhje;
- Numri i aktiviteteve të organizuara gjatë vitit 2025 janë 5 (pesë).

12. Për përmirësimin e funksionimit të KVR-së nevojitet mbështetje financiare për zhvillimin e më shumë aktiviteteve rinore, si dhe mundësi i takimeve me KVR-të e bashkive të tjera për shkëmbim përvojash.

13. KVR ka bashkëpunuar me projektin “Bashki të Forta”, zbatuar nga IDM, ku janë zhvilluar aktivitete dhe trajnime për forcimin e rolit të të rinjve në vendimmarrje.

14. Në territorin e Bashkisë Shijak operojnë grupe dhe organizime rinore që bashkëpunojnë me bashkinë në aktivitete të ndryshme rinore.

15. Bashkia Shijak ofron mbështetje për organizatat rinore në forma të ndryshme:

- Mbështetje financiare;
- Vënie në dispozicion të ambienteve publike;
- Konsulencë dhe trajnime falas;

- Mbështetje sipas nevojave dhe kërkesave të të rinjve.

16. Aktivitetet kryesore të organizuara ose të mbështetura gjatë vitit 2025 janë:

- Kampionati i Volejbollit për meshkuj dhe femra 15-18 vjeç;
- Kampionati i Shahut për moshat 9-14 vjeç;
- “Miss & Mister Shijak”;
- “Night Box”;
- Klubi i Artit dhe biseda mbi librin.

Gjithashtu, bashkia ka mbështetur skuadrat e volejbollit dhe basketbollit duke vënë në dispozicion ambiente falas dhe ka financuar projekte artistike të realizuara në Gjimnazin “16 Shtatori”.

17. Të rinjtë përfshihen në proceset vendimmarrëse përmes konsultimeve publike, forumeve rinore dhe rolit aktiv të Këshillit Rinor Vendor.

18. Gjatë vitit 2025 të rinjtë kanë marrë pjesë pothuajse në çdo konsultim publik të zhvilluar nga bashkia. Mekanizmat e përdorur përfshijnë takime të drejtpërdrejta me të rinjtë dhe organizimin e aktiviteteve “Open Day”.

19. Sfidat kryesore në angazhimin e të rinjve janë:

- Pjesëmarrja e ulët në konsultime dhe aktivitete;
- Mungesa e informacionit mbi rëndësinë e përfshirjes në vendimmarrje.

20. Po, Bashkia Shijak përdor platforma dhe mjete digjitale për të lehtësuar pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse.

21. Bashkia Shijak ofron mbështetje për sipërmarrjen rinore nëpërmjet:

- Mbështetjes financiare;
- Vënies në dispozicion të ambienteve publike;
- Ofrimit të konsulencës për të rinjtë.

22. Për vitin 2025 nuk referohen praktika suksesi specifike lidhur me të rinjtë.

23. Bashkia Shijak nuk ka programe specifike për grupe vulnerabël të të rinjve.

24. Numri total i përfituesve nga Skema e Ndihmës Ekonomike për vitin 2025 është 251, nga të cilët 129 femra dhe 122 meshkuj.

25. Numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues nga Skema e Ndihmës Ekonomike është 30, nga të cilët 18 femra dhe 12 meshkuj.

26. Numri total i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2025 është 645, nga të cilët 315 femra dhe 330 meshkuj.

27. Numri i të rinjve (15-29 vjeç) përfitues të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar është 12, nga të cilët 6 femra dhe 6 meshkuj.

28. Numri i personave që janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2025 është 2 (dy) persona, konkretisht në Njësinë Administrative Maminas dhe Njësinë Administrative Gjepalaj.

29. Numri i të rinjve (15-29 vjeç) që janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2025 është 2 (dy).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin ,

Shkresa përpilohet në 3 (tre) kopje